

## SKEDË INFORMUESE

### Informacion i përditësuar mbi thirrjen e hapur për Bashkitë “WiFi4WB – Iniciativa për Wi-Fi Publik Falas”

Nisma WiFi4WB është pjesë e projektit EU4Digital, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane dhe zbatohet nga GIZ. WiFi4WB ofron Wi-Fi falas në pika publike për deri në 500 bashki në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Ajo bazohet në suksesin e programit WiFi4EU të BE-së, që financoi 130 milionë euro për të krijuar rrjete Wi-Fi publike në rreth 9,000 bashki të BE-së.

Pikat e aksesit Wi-Fi do të instalohen në hapësira publike si sheshe, parqe, biblioteka, muze dhe shkolla, duke ofruar akses falas dhe të besueshëm në internet për banorët dhe vizitorët. Kjo nismë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së lidhjes në rajon, duke fuqizuar njerëzit për të komunikuar, mësuar dhe punuar në mënyrë më efektive në internet dhe është pjesë e një plani më të gjerë për të përshpejtuar tranzicionin dixhital në rajon, duke promovuar kështu integrimin e Ballkanit Perëndimor në Tregun Unik Dixhital të BE-së.

#### Synimi i thirrjes:

- Përmirësimi i infrastrukturës dixhitale në hapësirat publike.
- Sigurimi i qasjes falas në internet për banorët dhe vizitorët.
- Promovimi i përfshirjes sociale, arsimit dhe inovacionit, si dhe zhvillimit ekonomik lokal.
- Integrimi i rajonit në Tregun Dixhital të Bashkimit Evropian.

#### Fushat e veprimit të thirrjes:

- Instalimi i hotspot-eve për Wi-Fi në vende publike (sheshe, parqe, biblioteka, muze, shkolla etj.).
- Vlerësimi dhe përgatitja e infrastrukturës ekzistuese (lidhje interneti, hapësirë fizike, furnizim me energji).
- Sigurimi i një shërbimi të qëndrueshëm me mbështetje teknike, mirëmbajtje dhe shërbim fillestar për dy vjet.

#### Rezultatet e pritshme:

Nisma synon të krijojë minimalisht **300 rrjete Wi-Fi** në **300 bashki** brenda gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Bashkitë pjesëmarrëse do të marrin **një paketë gjithëpërfshirëse** që përfshin pajisjet **Wi-Fi, instalimin, shërbimin e internetit dhe mirëmbajtjen** për një periudhë **deri në tre vjet**. Afati i saktë kohor do të konfirmohet pasi të zgjidhen ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP).

Për të siguruar zbatim efikas, ISP-të do të kontraktohen përmes një procesi prokurimi të centralizuar të menaxhuar nga GIZ. Qëllimi është të zgjidhen **gjashtë ofrues—një për ekonomi**—të cilët do të jenë përgjegjës për instalimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve.

Ky proces përzgjedhjeje është i ndarë nga faza e përzgjedhjes së bashkisë dhe është thelbësore për përcaktimin e planit të zbatimit të projektit.

### **Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:**

- Thirrja është e hapur për të gjitha Bashkitë e Ballkanit Perëndimor nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.
- Për t'u kualifikuar për nismën WiFi4WB, aplikimi duhet të dorëzohet nga **kryetari/kryetari i bashkisë, një zyrtar i punësuar në bashki ose një anëtar i këshillit bashkiak.**

### **Detyrimet e Bashkive:**

Bashkitë do të kenë këto detyrime kryesore përpara se të marrin paketën mbështetëse, e cila përfshin pajisjet, instalimin, shërbimin e internetit dhe mirëmbajtjen:

- Bashkitë duhet të bien dakord për të ruajtur shërbimin Wi-Fi për të paktën një vit pas përfundimit të projektit, duke siguruar që shërbimi të vazhdojë t'i shërbejë komunitetit më gjatë. Përmes nismës, Bashkitë **do të bëhen pronare** të pajisjeve të nevojshme për vendosjen e rrjeteve Wi-Fi, me të gjitha kostot e instalimit të mbuluara plotësisht. Gjithashtu, **projekti do të ofrojë shërbimin e internetit dhe mirëmbajtjen deri në tre vjet.** Megjithatë, pasi të përfundojë kjo periudhë, Bashkitë do të jenë përgjegjëse për funksionimin e shërbimit dhe të angazhohen për të ruajtur shërbimin Wi-Fi për të paktën një vit shtesë duke mbuluar i tarifës mujore të shërbimit të internetit (çmimi do të përcaktohet gjatë përzgjedhjes së ofruesve të shërbimeve të internetit), ose
- Kryerja e një procesi të veçantë prokurimi për të kontraktuar një ofrues tjetër të aftë për të ofruar shërbimin e internetit duke përdorur pajisjet ekzistuese.
- Bashkitë janë përgjegjëse për sigurimin e çdo leje ose miratimi të kërkuar për instalimin dhe funksionimin e pajisjeve Wi-Fi në vendet e propozuara.
- Bashkitë duhet të sigurojnë që të ketë të paktën një prizë elektrike të aksesueshme në vendet e zgjedhura për të mbështetur funksionimin e pandërprerë të pajisjeve Wi-Fi. Gjatë instalimit, ofruesi i shërbimit të internetit mund të zhvendosë prizën nëse nevojitet për të optimizuar vendosjen e pikave të aksesit.

### **Si bëhet aplikimi:**

- **Regjistrimi:** Bashkitë duhet të regjistrohen në faqen e internetit të iniciativës duke plotësuar formularin me informacion bazë dhe duke caktuar një kontakt.
- **Aplikimi:** Pas regjistrimit në sistem, aplikimi duhet të dorëzohet me marrëveshje paraprake dhe autorizim zyrtar nga Kryetari i Bashkisë. Modeli për dokumentin e Marrëveshjes gjendet në faqen e internetit të WiFi4WB nën seksionin Kush mund të aplikojë, **PROOF OF AGREEMENT**. Dokumenti i marrëveshjes duhet të shkarkohet dhe firmoset nga Kryetari i Bashkisë dhe pastaj duhet të ngarkohet në sistem gjatë procesit të aplikimit.
- Në sistem duhet të përcaktohen deri në **tre vende** për instalimin e rrjetit Wi-Fi falas. Meqenëse do të **përzgjidhet vetëm një vend**, është e rëndësishme që të listoni vendet sipas prioritetit, ku vendi i parë konsiderohet si preferenca

kryesore e bashkisë dhe merr përparësi në procesin e përzgjedhjes. Jepni detaje thelbësore për çdo vend të propozuar, duke përfshirë madhësinë (në metra katrorë), nëse është një hapësirë e brendshme apo e jashtme, infrastrukturën ekzistuese të internetit dhe çdo kërkesë për leje. Nëse nevojiten leje, konfirmoni angazhimin e bashkisë për t'i siguruar ato. Vendet e propozuara duhet të kenë infrastrukturën e nevojshme bazë, të tilla si kabllo koaksiale, fibrash ose telefonike dhe hapësirë fizike për të akomoduar pajisjet Wi-Fi.

- Në aplikim konfirmoni që bashkia pranon të marrë pjesë në nismën WiFi4WB dhe të marrë Wi-Fi publik falas, duke përfshirë pajisjet teknike, instalimin dhe mirëmbajtjen deri në tre vjet. Afati i saktë kohor do të përcaktohet pasi të zgjidhen ofruesit e shërbimeve të internetit. **Pas kësaj periudhe të financuar plotësisht, bashkia angazhohet të mbulojë koston e shërbimit të internetit për të paktën një vit shtesë.** Kjo siguron vazhdimësi dhe mbështet qëndrueshmërinë afatgjatë të aksesit publik në internet.

#### **Afati i fundit:**

- Thirrja do të qëndrojë e hapur deri më **28 prill**, por për shkak të interesit të lartë, ju rekomandojmë të dorëzoni aplikimin tuaj menjëherë pas hapjes për të rritur shanset për të përfituar rrjetin Wi-Fi.

Aplikimet do të shqyrtohen në bazë të parimit kush aplikon i pari shqyrtohet i pari. Prandaj, bashkitë inkurajohen të regjistrohen herët dhe të përgatiten për të dorëzuar aplikimet e tyre sapo të hapet thirrja më 28 mars 2025.

Për të siguruar akses të barabartë, të **paktën 25% e gjithsej 300 bashkive të përzgjedhura do të jenë nga zona më pak të populluara.** Bashkitë me **më pak se 50 banorë për kilometër katror do të kenë përparësi për të marrë mbështetje** për të adresuar mungesat e infrastrukturës dixhitale dhe për të mbështetur zhvillimin e balancuar rajonal.

Pasi të zgjidhen bashkitë dhe të prokurohen ofruesit e shërbimeve të internetit, do të fillojë konfigurimi i rrjeteve Wi-Fi. Vendosija e rrjeteve individuale Wi-Fi pritet të fillojë **në tremujorin e fundit të vitit 2025.**

#### **Linku i thirrjes:**

<https://wifi4wb.eu>

Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose ndihmë shtesë mbi këtë thirrje, na njoftoni!